



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. _____ prot.

Laç, më _____.____.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 25.10.2021

Drejtuari: Operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, **Adresa:** Shkoder, Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Punë (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-05033-09-10-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndërtim, Rikonstruksion i KUZ Milot”.

Fondi limit: 4,966,667 (katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 28 ditë kalendarike duke filluar nga data e nenshkrimit te kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.140, datë 20.09.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “LALA” SHPK, me numër NIPTI **J76418903B**.

Vlera e ofertuar: **4,729,925** (katër milion e shtatëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë **pa TVSH**.

2. Operatori ekonomik “2 N” SHPK, me numër NIPTI L31615017L.
Vlera e ofertuar: **2,813,325** (dy milion e tetëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e njëzet e pesë) lekë **pa TVSH.**
3. Operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK, me numër NIPTI K53002402C.
Vlera e ofertuar: **4,375,350** (katër milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë **pa TVSH.**
4. Operatori ekonomik “NIKA” SHPK, me numër NIPTI J76705047U.
Vlera e ofertuar: **3,665,260** (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë **pa TVSH.**
5. Operatori ekonomik “OUEN” SHPK, me numër NIPTI K17529215O.
Vlera e ofertuar: **4,950,000** (katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë **pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “2 N” SHPK, me numër NIPTI L31615017L.
2. Operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK, me numër NIPTI K53002402C.
3. Operatori ekonomik “OUEN” SHPK, me numër NIPTI K17529215O.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “2 N” SHPK, me numër NIPTI L31615017L.

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”,** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik “2N” Shpk rezultoi nga KVO ofertë anomalisht e ulët dhe ndodhur në këto kushte me datë 12.10.2021 KVO, në mbështetje të nenit të nenit 93 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të nenit 82, pika 4, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, vendosi t’i kërkoj operatorit ekonomik “2 N” SHPK, që të paraqesë

me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime duke argumentuar nga ana tekniko-ekonomike realizimin e ofertës së paraqitur

Duke qene se operatori ekonomik nuk solli shpjegime për ofertë anomalisht të ulët brenda afateve ligjore, KVO vendosi ta refuzojë ofertën e operatorit ekonomik duke e skualifikuar.

2. Operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK, me numër NIPTI K53002402C.

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se; **"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....."**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson kriteret e DST, përkatësisht:

- KVO konstatoi se OE “ASI-2A CO” SHPK nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt ligjor për plotësimin e kriterit:
Oferta ekonomike e paraqitur nga ky OE ka gabime aritmetike, e shprehur në vlerë absolute 5% të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.
Konkretisht OE ka ndërhyrë duke ndryshuar preventivin e publikuar në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së, duke shtuar një zë të veçantë, me emërtimin FOND REZERVE 5% me vlerë 208,350 lekë pa TVSH.
Vlera e ofertuar nga OE “ASI-2A CO” SHPK e përcaktuar në preventiv si dhe në formularin e ofertës ekonomike është: 4,375,350 lekë pa Tvsh dhe 5,250,420 lekë me Tvsh.
Ndërsa vlera e korrigjuar (e saktë) që duhej të paraqitej nga ky OE është 4,167,000 lekë pa Tvsh dhe 5,250,420 lekë me Tvsh.
Sa më sipër bazuar në nenin 82, pika 3, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe duke qenë se shumica absolute e korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, KVO vendosi skualifikimin e OE “ASI-2A CO” SHPK.

3. Operatori ekonomik “OUEN” SHPK, me numër NIPTI K17529215O.

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021

“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 2-1.b të DST, përkatësisht:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 99.333 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

KVO konstatoi se: OE “OUEN” SHPK, nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, kriter ky i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

2. OE nuk plotëson pikën 2.3.3 të DST, përkatësisht:

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Inxhinier Ndertimi 1 (një)

2. Inxhinier Topograf / Markshajder 1 (nje)

3. Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)

Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të pakten 3 (tre muajt) e fundit.

Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë pune (e vlefshme), Diploma dhe CV.

Kjo kerkese do të quhet e përmbushur gjate fazes se ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit). Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të paraqese perpara nenshkrimin te kontrates dokumentin e deklaruar ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

KVO konstatoi se: OE “OUEN” SHPK, nuk disponon dokumentacion të rregullt për Inxhinier Topograf. Sqarojmë se OE në shtojcën Nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit) që ka paraqitur, ka deklaruar për Inxhinier Topograf Z. Hajri Lami, i cili nuk figuron në Licencën e shoqërisë, kriter ky i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

3. OE nuk plotëson pikën 2.3.5 të DST, përkatësisht:

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjesit si me poshte:

- 1 punonjës saldator,
- 1 punonjës hidraulik
- 1 Specialist për montimin e tubave
- 3 Manovrator

a) Punonjesit (Saldator, Hidraulik, Specialist per montimin e tubave) duhet të jenë të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga organe

kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013. Për keta punonjes të paraqiten dëshmite përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik, kontratat individuale të punës të vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3 (tre muajt) e fundit.

b) Për punonjësit (Manovrator) të paraqiten, kontratat e punës të vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figuronje në listëpagesat e shoqërisë ose të kontraktuar me kontrate të vlefshme.

Kjo kerkese do të quhet e permbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari përmbledhës i vetedeklarimit**). Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara nenshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

KVO konstatoi se: OE “OUEN” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt si dhe nuk ka deklaruar për punonjësit 1 (një) Specialist për montimin e tubave dhe 1 (një) Manovrator. Sqarohet se OE në shtojcën Nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit) që ka paraqitur, ka deklaruar 2 (dy) Manovrator Z.Urim Reçi dhe Z.Ouen Hilaj. Por AK ka kërkuar në DST 3 (tre) Manovrator si dhe ka kërkuar 1 (një) Specialist për montimin e tubave, specialist të cilin OE nuk e ka deklaruar në shtojcën 8. Sa më sipër OE nuk plotëson kriteret për 1 (një) Specialist për montimin e tubave dhe 1 (një) Manovrator, kriteret këto të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në DST.

4. OE nuk plotëson pikën 2.3.6 të DST, përkatësisht:

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; Kontrata e punës të vlefshme, Diploma dhe CV.

Kjo kerkese do të quhet e permbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari përmbledhës i vetedeklarimit**). Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara nenshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

KVO konstatoi se: OE “OUEN” SHPK, nuk ka deklaruar Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, në shtojcën Nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit) që ka paraqitur, si dhe nuk ka paraqitur asnjë deklaratë tjetër për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, kriter ky i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

5. OE nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST, përkatësisht:

KVO konstatoi se: OE “OUEN” SHPK, nuk ka deklaruar në shtojcën Nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit) që ka paraqitur, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për 1 (një) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min.10 ton, për Cekic pneumatik si dhe për Aparat për ngjitje tubosh, kriteret këto të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**NIKA**” SHPK, me adresë: Shkoder, Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3,665,260** (tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë **pa TVSH** është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA